

Ndërtimi i një partneriteti të qëndrueshëm me qytetarin për mbrojtjen e mjedisit: **Sfidat dhe rruga përpara**



Përgatitur nga: Dr. Albana Rexha

Copyright© 2021. **Democracy Plus (D+)** dhe **Konrad-Adenauer-Stiftung**

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet ose të transmetohet në ndonjë formë ose me ndonjë mjet, elektronik, mekanik, fotokopjues ose tjetër, pa lejen e D+.

Ky botim u mbështet nga Konrad Adenauer Stiftung (KAS). Pikëpamjet e shprehura nuk pasqyrojnë detyrimisht pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung.

Ky botim i i Konrad-Adenauer-Stiftung është menduar vetëm për qëllime informacioni. Ai nuk mund të përdoret nga partitë politike ose nga fushatat ose mbështetësit e zgjedhjeve për qëllime të reklamimit në zgjedhje. Kjo vlen për zgjedhjet federale, shtetërore dhe lokale, si dhe zgjedhjet për në Parlamentin Evropian.

Ky shënim i shkurtër politikash është shkruar në gjuhën angleze, andaj për çdo paqartësi në këtë version të përkthyer dhe përshtatur, të lutem konsultohuni me versionin origjinal "Building a Sustainable Partnership with the Citizen on Environmental Protection: Challenges and the Way Forward".

Përmbajtja

Hyrje	4
Akterët kryesorë të politikave institucionale dhe roli i tyre	6
Hartëzimi i akterëve dhe programeve kryesore:	6
Roli i akterëve shoqërorë:	8
Konkluzionet dhe rekomandimet për politika	10

Hyrje

Mbrojtja e mjedisit dhe problemet mjedisore janë përgjegjësi globale; prandaj, ato kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme të koordinuara në mbarë botën. Përmirësimi i një indikatori të qeverisjes mjedisore për një vend nuk përkthehet domosdoshmërisht në indikator më të mirë të përgjithshëm. Për shembull, nëse deponitë ilegale janë problemi, dhe nëse ky problem 'zgjidhet' duke i zhvendosur nga një vend i zhvilluar në një vend në zhvillim – kjo zgjidhje nuk është e qëndrueshme. Një zgjidhje e tillë e paqëndrueshme do të nënkuptonte zhvendosjen e mbeturinave nga njëra dhomë në dhomën tjetër, duke e shkatërruar shtëpinë që na strehon.

Natyra dhe mjedisi janë përgjegjësi



kushtetuese për çdo qytetar kosovar dhe institucionet publike duhet t'ua ofrojnë të gjithëve një mundësi institucionale për të kontribuar në hartimin e politikave mjedisore¹. Meg-

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin]

jithatë, vetëm 16.1% dinë shumë për këtë temë, ndërsa 15.2% e qytetarëve nuk kanë njohuri për këtë temë; dhe 68.7% dinë pak ose kanë njohuri mesatare për këtë të drejtë². Sipas të njëjtit raport, të dhënat e ndara sipas gjinisë për njohuritë për këtë temë e tregojnë një diferencë prej 3 pikësh në përqindje në favor të burrave. Në anën tjetër, nuk ka të dhëna të ndara sipas moshës, ndonëse do të ishin informative për vendimmarrësit lidhur me atë se cilat grupmosha në shoqëri janë të pavëmendshme ndaj çështjeve mjedisore dhe cilat grupe janë të vetëdijshme për problemet dhe sfidat e tilla. Këto statistika të perceptimit të të dhënave e portretizojnë një pamje shqetësuese të gjendjes sa u përket njohurive publike lidhur me të jetuarit në një mjedis të shëndetshëm, në mbarë Kosovën.

Në anën tjetër, shkencëtarët dhe udhëheqësit globalë po bëjnë thirrje për zgjidhje të qëndrueshme për ta mbrojtur mjedisin nga ndryshimet klimatike para se të bëhet shumë vonë. Raporti i vitit 2021 nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike thekson se

“Është e qartë se ndikimi njerëzor e ka ngrohur atmosferën, oqeanin dhe tokën. Ndryshimet e përhapura dhe të shpejta në atmosferë, oqean, kriosferë dhe biosferë kanë ndodhur”³.

Në këtë luftë globale për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës duke i kontrolluar ndryshimet klimatike, gjeneratat e reja duhet ta luajnë një rol kyç, sepse ata do të bartin barrën më të rëndë të ndikimeve klimatike. Prandaj, në dhjetor të

2 Përmbledhje e Pulsit Publik XXI. (2021). UNDP. Në dispozicion në <https://dpl.us/m9d>

3 Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike. (2021). “Ndryshimet Klimatike 2021- Baza e Shkencave Fizike – Përmbledhje për Politikëbërësit” Kontributi i Grupit Punues I në Raportin e Gjashtë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike.

vitit 2019, qeveritë dhe aktivistët e rinj u bashkuan për ta nënshkruar Deklaratën Ndërqeveritare për Fëmijët, Rininë dhe Veprimin ndaj Klimës⁴. Kjo deklaratë, mes tjerash,

i pranon fëmijët dhe të rinjtë si agjentë të ndryshimeve klimatike;

avokon për njohjen dhe realizimin global të së drejtës së patjetërsueshme të fëmijëve në mjedis të shëndetshëm;

bën thirrje për forcimin e kapacitetit të fëmijëve dhe të rinjve për zbutjen e ndryshimeve klimatike duke krijuar dhe investuar në ndryshimin e klimës dhe edukimin mjedisor.

Për më tepër, një numër i madh i aktivistëve mjedisorë të rinj kanë qenë aktivë në mbarë botën. Njëra nga ta është aktivistja suedeze, Greta Thunberg, e cila nga një nxënëse e shkollës së mesme është shndërruar në udhëheqëse globale mjedisore. Thunberg ia ka nisur duke organizuar protesta jashtë parlamentit dhe duke u bërë thirrje që t'u përmbahen të gjitha pikave të Marrëveshjes së Parisit. Kjo nismë e saj u bë nismë globale e të Premteve që njihen si Të Premtet për të Ardhmen⁵. Kjo nismë e ka ngritur vetëdijen për mjedisin në mesin e popullatës së re nëpër botë dhe ka kërkuar që të rinjtë të angazhohen në hartimin e politikave mjedisore, duke kërkuar nga qeveritë në mbarë botën që të ndër marrin veprime urgjente për krizën klimatike.

Të rinjtë midis moshës 15 dhe 24 vjeç përbëjnë 35% të popullsisë së Kosovës, ndërsa mbi 65% janë nën moshën 30 vjeç⁶. Këto statistika demografike e japin një pamje të qartë se Kosova është vend i ri me shumicë të popullsisë rinore. Kështu, të rinjtë duhet të jenë në qendër të

vendimeve për mjedisin, duke e modeluar të ardhmen e tyre. Duke e pasur parasysh faktorin demografik, në këtë përmbledhje ne i kemi trajtuar vetëm politikat publike mjedisore me rininë në qendër dhe edukimin e të rinjve për politikat që kanë të bëjnë me mjedisin. Deri në çfarë mase janë të rinjtë në Kosovë të përfshirë në hartimin e politikave mjedisore ose përmes mekanizmave institucionalë? A ka qasje institucionale të strukturuar për t'i edukuar të rinjtë për mbrojtjen e mjedisit dhe për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm? A luajnë akterët shoqërorë të tjerë rol në forcimin apo edukimin e të rinjve për të drejtat e tyre mjedisore dhe sfidat mjedisore?

Me qëllim të trajtimit të këtyre çështjeve dhe zbulimit të shkallës në të cilën po ndërtohet partneriteti i qëndrueshëm me të rinjtë kosovarë për ta mbrojtur mjedisin, kjo përmbledhje e politikave i kontribuon nisjes së një diskutimi publik për nevojën për ta shtuar pjesëmarrjen e të rinjve në politikat mjedisore, për t'i edukuar dhe për t'i njohur ata si agjentë të ndryshimit.

Në këtë përmbledhje të shkurtër, duke u bazuar në intervista, hulumtime në zyrë dhe në përvijën tonë si organizatë aktive në promovimin e përfshirjes së të rinjve në qeverisjen mjedisore përmes mjeteve digjitale, ne e vlerësojmë gjendjen aktuale të angazhimit të të rinjve në politikat mjedisore. Ne po ashtu i identifikojmë strukturat qeveritare përgjegjëse për aspektet që kanë të bëjnë me arsimin. Në fund, ne ofrojmë një varg rekomandimesh për politika që i adresojnë këto çështje dhe që synojnë ngritjen enjohurive dhe kapaciteteve të të rinjve drejt mbrojtjes së mjedisit dhe aftësisë për të kërkuar llogaridhënie nga politikëbërësit.

4 Deklarata për Fëmijët, Rininë dhe Veprimet Klimatike. 9 dhjetor 2019. Konferenca e Njëzetepestë e Palëve në Madrid, Spanjë. Në dispozicion në <https://dpl.us/901>

5 Për më shumë shih <https://dpl.us/rvg>

6 Për më shumë shih <https://dpl.us/jmc>

Akterët kryesorë të politikave institucionale dhe roli i tyre

Problemet serioze mjedisore në Kosovë kanë të bëjnë me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, biodiversitetin e rrezikuar dhe shpyllëzimin dhe kanë ndikim negativ të drejtpërdrejtë në shëndetin e popullatës⁷. Duke e marrë parasysh demografinë e vendit që u shtjellua më lart, ndikimi është më i larti tek të rinjtë.

Në vitin 2013, sipas një raporti të Bankës Botërore për analizën mjedisore në Kosovë, prioritetet mjedisore ishin planifikuar të ishin në përputhje me korpusin ligjor të BE-së, duke i përmbushur në mënyrë të qëndrueshme standardet e BE-së brenda pesë viteve⁸. Sipas të njëjtit burim, sa i përket kostos së BPV-së, kostoja vjetore e degradimit të mjedisit në Kosovë vlerësohet të jetë deri në 327 milion euro dhe kjo është afër 7% e BPV-së⁹. Dokumenti i parë e pasqyron një plan për ta përmirësuar gjendjen e mjedisit, por, megjithatë, pas më shumë se shtatë vitesh (pas raportit të Bankës Botërore të vitit 2013), gjendja mjedisore vazhdon të jetë shqetësuese dhe të përballet me një numër problemesh të nivelit të lartë.

Ndërkaq, në kohën kur është shkruar kjo përmbledhje e politikave, është viti 2021 dhe sipas Raportit më të fundit të Komisionit Evropian për Kosovën "Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Është arritur përparim i kufizuar...(2020)"¹⁰.

Katër rekomandimet kryesore të raportit të vitit 2019 nuk janë përmbushur dhe janë përsëritur në raportin e vitit 2020. Këto rekomandime e trajtojnë nevojën për ta krijuar një sistem efektiv të monitorimit të ujërave, për ta rritur mbulimin me mbledhje të mbeturinave, për t'i zbatuar dispozitat ligjore për përgjegjësinë mjedisore dhe për ta

zbatuar strategjinë e ndryshimeve klimatike dhe planit të veprimit për ndryshimet klimatike.

Për më tepër, Parlamenti Evropian në rezolutën e tij për Kosovën u ka bërë thirrje dhe i ka inkurajuar institucionet vendore që ta sigurojnë përafrimin me standardet e BE-së dhe objektivat e politikave për mbrojtjen klimatike dhe mjedisin në përputhje me zotimet që janë marrë sipas Marrëveshjes së Parisit dhe objektivin strategjik të arritjes së neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050 si pjesë e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane¹¹. Në këtë rezolutë po ashtu theksohet se Parlamenti është «thelësisht i shqetësuar se shumica dërrmuese e energjisë në Kosovë buron nga thëngjilli, si dhe termocentralet...»¹². Kjo rezolutë, sikur dokumentet e tjera nga BE-ja që ofrojnë vlerësime të bazuara në prova, i nxit institucionet që të veprojnë dhe ta përmirësojnë gjendjen e mjedisit.

Hartëzimi i akterëve dhe programeve kryesore:

Akterët që udhëzojnë, iniciojnë, shkruajnë, monitorojnë, edukojnë dhe i zbatojnë politikat publike mjedisore dhe përfshirjen e të rinjve në politikat e tilla gjenden në sektorin qeveritar dhe joqeveritar në Kosovë. Në paragrafët në vijim, ne i trajtojmë aktivitetet e tyre krahasuar me rolin dhe vizionin e tyre.

Për fillim, Programi Mjedisor i Kosovës (PMK) është program kompleks që e parasheh finalizimin e dokumenteve, studimeve dhe analizave të ndryshme në formë të shënimeve, procesverbaleve, materialit trajnues, raporteve me kapituj dhe librave¹³. PMK-në e financon Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), ndërsa institucionet përfituese kryesore janë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejshëm Ministria) dhe Këshilli Ndërmjësor i

7 Programi Mjedisor i Kosovës (KMP). Shihni më shumë në <https://dpl.us/r9m>

8 Banka Botërore. (2013). "Analiza mjedisore e shtetit për Kosovën - Vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin".

9 Po aty.

10 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020.

11 Rezoluta e Parlamentit Evropian për Raportin e Komisionit 2019-2020 për Kosovën, mars 2021. E disponueshme në dispozicion në <https://dpl.us/jwj>

12 Po aty.

13 Programi Mjedisor i Kosovës (KMP). Shihni më shumë në <https://dpl.us/vli>

Ujërave (KNMU). Ky i fundit është një komision që përbëhet nga ministrat përkatës të qeverisë të kryesuar nga zëvendëskryeministri përgjegjës për përmirësimin e gjendjes në sektorin e ujërave përmes vlerësimit sistematik dhe hartimit të politikave të reja në përputhje me praktikën e mira të BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Së dyti, si përfituesja kryesore, Ministria është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e të gjitha politikave në fushën e mjedisit, ujërave, mbeturinave, menaxhimit, mbrojtjes së ajrit, mbrojtjes së natyrës, banimit, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit. Në mesin e departamenteve të kësaj ministrie është një departament për mbrojtjen e mjedisit, i cili i ka katër divizione, duke përfshirë 1) atë për ujërat, 2) divizionin për menaxhimin industrial, 3) divizionin për kimikate dhe mbeturina dhe 4) divizionin për mbrojtjen e natyrës.

Në thelb, dikush do të mendonte se përgjegjësia për ta informuar dhe edukuar publikun, në veçanti gjeneratat e reja, hyn në kuadër të përgjegjësisë të kësaj Ministrie. Duke i edukuar gjeneratat e reja për nevojën për ta mbrojtur mjedisin, ne po ashtu i fuqizojmë ata si akterë në qeverisjen mjedisore. Kështu, arsimit mbetet parakusht kryesor drejt ndërtimit të një partneriteti të qëndrueshëm me të rinjtë. Ky parakusht është mishëruar edhe në Deklaratën Ndërqeveritare për Fëmijët, Rininë dhe Veprimin ndaj Klimës¹⁴.

Megjithatë, për shkak të ristrukturimit të Ministrisë në vitin 2017, Departamenti për Arsimin u shpërbë dhe ky ekip iu bashkua Divizionit të Komunikimit Publik¹⁵. Bazuar në të dhënat e intervistave, ky Departament para shpërbërjes i kishte kompetencat për t'i edukuar qytetarët lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe të jetuarit në një mjedis të shëndetshëm.

Aktivitetet e organizuara nga ish-Departamenti i Arsimit në këtë ministri përfshinin, ndër të tjera, orët mësimore njëditore që kishin të bënin me mjedisin në shkollat fillore dhe të mesme në mbarë vendin. Ndonëse, që kur janë bërë këto ndryshime strukturore, dimensionin e arsimit është lënë jashtë dhe asnjë divizion tjetër nuk i ka marrë këto përgjegjësi¹⁶.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se kjo ministri i shënon ditët ndërkombëtare siç është ajo e tokës, mjedisit dhe të ngjashme, duke u bashkërenduar me divizionin për komunikim. Gjatë këtyre ditëve, për qëllime edukative, ata publikojnë broshura të ndryshme dhe i shpërndajnë ato tek qytetarët, duke i synuar të rinjtë.

Shënimi i këtyre ditëve është i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për ta edukuar qytetarin, veçanërisht qytetarin e ri, drejt mbrojtjes së mjedisit dhe së drejtës së tij për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm. Në të njëjtën kohë, Ministria nuk ka ndonjë strategji/cak/rregullore të veçantë që e synon përfshirjen e të rinjve në hartimin e politikave që kanë të bëjnë me mjedisin. Sipas të dhënave të intervistave, është sfiduese që të rinjtë të përfshihen në procese të tilla për arsye të ndryshme, përfshirë mungesën e njohurive për mjedisin, mungesën e njohurive për hartimin e politikave, dhe jo vetëm; nuk ka interes të mirëfilltë madje as në mesin e atyre që paguhën për hartimin e politikave të tilla¹⁷.

Krahas kësaj, veglat që përdoren gjatë procesit të hartimit janë të njëjta si për çdo politikë publike tjetër, qoftë ajo ligj apo strategji, ndërsa ata nuk bashkëpunojnë për ta nxitur pjesëmarrjen e të rinjve në hartimin apo monitorimin e politikave mjedisore në asnjë dimension tjetër.

Për më tepër, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, kjo ministri e ka krijuar një agjenci që është quajtur Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (AMMK). AMMK-ja, si institucion qeveritar, është përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e cilë-

14 Deklarata për Fëmijët, Rininë dhe Veprimet Klimatike. 9 dhjetor 2019. Konferenca e Njëzetepestë e Palëve në Madrid, Spanjë. Në dispozicion në <https://dpl.us/x5x>

15 Intervista me Ismail Hetemajn. Shef i Divizionit për Mbrojtjen e Natyrës. Departamenti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ujërave. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës 16 gusht 2021: Prishtinë.

16 Po aty.

17 Po aty.

sisë dhetributeve mjedisore për një mjedis të shëndetshëm dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm¹⁸. Megjithatë, asnjë nga aktivitetet publike të saj nuk i ka për cak të rinjtë apo edukimin e tyre për ndikimin e mjedisit në jetën e tyre apo për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm. Shumica e aktiviteteve të saj përfshijnë konferenca që e trajtojnë gjendjen e energjisë, mbrojtjen e mjedisit përmes energjisë apo monitorimin e mjedisit¹⁹.

Meqenëse, siç u shpjegua në fillim, kjo përmbledhje e politikave synon edukimin dhe përfshirjen e të rinjve në politikat mjedisore, është thelbësore që të diskutohet për Ministrinë e Rinisë, Kulturës dhe Sportit si akter tjetër kryesor politik në këtë fushë. Kjo ministri, në mesin e departamenteve të tjera, e ka një Departament të Rinisë. Misioni i këtij departamenti është që t'i forcojë dhe mbështesë zërat e të rinjve, duke e krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillim dhe pjesëmarrje në jetën publike²⁰.

Sipas të dhënave nga intervistat, kjo ministri nuk përfshin ndonjë objektiv lidhur me edukimin e të rinjve për politikat mjedisore, por aktivitete të ndryshme që përfshijnë të rinjtë në ngritjen e vetëdijes mjedisore për të rinjtë²¹. Çdo vit, ajo jep grante për organizatat joqeveritare të të rinjve, por ato nuk i kanë për cak aktivitetet mjedisore; megjithatë, aktivitetet që kanë të bëjnë me edukimin mjedisor nuk përjashtohen nga financimi.

Për më tepër, disa nga aktivitetet mjedisore të të rinjve, që janë përmendur nga Drejtori i Rinisë, përfshijnë mbështetjen financiare për kompetencat ose aktivitetet e ndryshme vullnetare²². Krahas kësaj, nuk është theksuar asnjë bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit për qëllime të ngjashme.

Roli i akterëve shoqërorë: Akterë të tjerë, duke përfshirë strukturat e formalizuara, siç janë organizatat e shoqërisë civile apo partitë politike dhe strukturat e paformalizuara, siç janë lëvizjet, mund të luajnë rol në hartimin e politikave mjedisore.

Në Kosovë, roli i akterëve joqeveritarë, e në veçanti i organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve), në politikat publike dhe ngritje të vetëdijes është evident. Ka gjithashtu numër të madh të OSHC-ve që i synojnë politikat mjedisore, por jo domosdoshmërisht të rinjtë.

Për më tepër, pjesëmarrja e të rinjve në mbrojtjen e mjedisit merr forma të ndryshme, siç janë grupet e të rinjve, lëvizjet mjedisore, këshillat e të rinjve dhe të ngjashme. Ndonëse në Kosovë haset kryesisht një grup më formal siç janë organizatat e shoqërisë civile, shembujt e të cilave janë shtjelluar në pjesën e mësipërme. Kjo e portretizon rolin e jashtëzakonshëm të OSHC-ve në krahasim me qeverinë sa i përket ngritjes së vetëdijes në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Në mesin e organizatave që synojnë ta shtojnë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje dhe t'i avancojmë njohuritë e tyre për mjedisin është edhe organizata jonë, Demokraci Plus (D+). D+ e ka lansuar një platformë online të titulluar www.ndreqe.com

Kjo platformë shërben si vegël online për qytetarët e Kosovës, duke i synuar të rinjtë, që t'i raportojnë problemet që kanë të bëjnë me mjedisin, përfshirë deponitë ilegale. Sipas të dhënave publike në këtë platformë, janë raportuar 3654 raste, 1563 nga të cilat janë zgjidhur nga komunat në mbarë Kosovën. Për më tepër, D+ po ashtu mban takime me të rinjtë në mbarë Kosovën për ta ngritur vetëdijen për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe për pasojat e të jetuarit në një mjedis të varfër. Të rinjtë që jetojnë në zonat rurale po ashtu janë në shënjestër përmes takimeve dhe tubimeve të ndryshme. Krahas kësaj, D+ i informon dhe inkurajon të rinjtë vazhdimisht për platformën online (www.ndreqe.com)

18 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Për më shumë shih <https://dpl.us/yqh>

19 Për më shumë, shih aktivitetet e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në <https://dpl.us/026>

20 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Për më shumë shih <https://dpl.us/pey>

21 Intervista me Xhevat Bajramin. Shef i Divizionit për Rininë. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. 12 gusht 2021: Prishtinë.

22 Po aty.

Për më tepër, ka organizata të tjera që veprojnë në Kosovë dhe që, përmes dhënies së granteve për mjedisin, në cak i kanë të rinjtë. Për shembull, Fondacioni Ballkani i Gjelbër i ka financuar aktivitetet e OShC-ve vendore lidhur me përfshirjen e të rinjve në vendimmarrjen mjedisore, fushatat e ngritjes së vetëdijes për mjedisin në nivel lokal dhe parandalimin e ndotjes së ajrit²³. Kjo organizatë dhe aktivitetet e saj financohen nga akterë ndërkombëtarë siç janë fondet e BE-së, ndërsa skemat e tyre për dhënie të granteve bazohen në këto fonde.

Ekziston një organizatë tjetër që quhet Let's Do It Kosova! dhe që është pjesë e lëvizjes globale Let's Do It World! që ka filluar në Estoni në vitin 2008. Qëllimi kryesor i kësaj organizate është mbrojtja e mjedisit duke e lehtësuar organizimin e qytetarëve në aktivitete të ndryshme vullnetare në drejtim të mbrojtjes së mjedisit në mbarë vendin²⁴.

Në përgjithësi, mund të vërehet se organizatat e shoqërisë civile janë më aktive në afrimin e të rinjve dhe edukimin e tyre përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme krahasuar me akterët institucionalë. Organizata të ndryshme e aplikojnë një qasje proaktive, duke lëvizur përtej datave simbolike të tokës dhe ajrit, për të aspiruar dhe për t'i edukuar të rinjtë për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm.

Akter shoqëror tjetër kyç për hartimin e politikave mjedisore janë partitë politike. Partitë politike i kanë kapacitetet për ta ngritur vetëdijen e të rinjve dhe për t'i përfshirë ata në mbrojtjen e mjedisit, falë strukturave të tyre të vendosura nëpër qytete dhe fshatra në mbarë vendin. Megjithatë, nuk mund ta evidentojmë ndonjë aktivitet sistematik të mbajtur nga asnjë parti politike në Kosovë drejt ndërtimit të një partneriteti me të rinjtë për t'i dhënë prioritet mjedisit dhe për ta mbrojtur atë në këtë mënyrë.

Nga analiza e mëtejshme e programeve të partive politike të zgjedhjeve të fundit kombëtare (14 shkurt 2021) mund të kuptohet se agjenda e gjelbër nuk pasqyrohet dhe nuk është pjesë e programeve të tyre²⁵. Nëse partitë politike nuk e fusin mjedisin në programin e tyre, është joreale të mendohet se do t'i japin prioritet apo do ta lehtësojnë përfshirjen e të rinjve në hartimin e politikave për mjedisin posa të vijnë në pushtet.

Në të njëjtën kohë, bëhet sfiduese për këto parti politike që, sapo të vijnë në pushtet, të përballen me sfidën e qeverisjes së bashkëveprimit njerëzor me mjedisin në interes të qëndrueshmërisë, nëse nuk e kanë planifikuar këtë më parë.

Megjithatë, e njëjta qasje e pavëmendshme ndaj mjedisit nuk është e pranishme në zgjedhjet kombëtare në nivel vendi (që janë mbajtur më 17 tetor 2021). Për shembull, kandidatët për kryetar komune të Prishtinës mjedisin e kanë pasur njëherë nga shtyllat kryesore të programit²⁶. Programet si "Prishtina e pastër" apo "Prishtina e gjelbër" bazohen në një numër projektesh dhe aktiviteteve në thelb të të cilave qëndron një politikë mjedisore e qëndrueshme. Edhe pse e njëjta gjë nuk vlen për të gjithë kandidatët për kryetar komune në mbarë vendin, rasti i kryeqytetit është hap i madh përpara në priorizimin e politikave mjedisore në nivelin politik lokal.

Për ta përmbledhur, analiza e integritetit mjedisor në programin e partive politike në nivel lokal ndryshon pozitivisht nga programi i partive politike në nivel kombëtar. Edhe pse mjedisi nuk u pasqyrua si prioritet në nivel kombëtar, ky dimension është evident në nivelin lokal.

23 Intervista me Besfort Kosovën. Fondacioni Ballkani i Gjelbër. 25 gusht 2021, Prishtinë.

24 Për më shumë lidhur me këtë organizatë dhe aktivitetet e saj, shih <https://dpl.us/x8r>

25 INDEP. (2021). "Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2021: Programet e Partive Politike dhe Agjenda e Gjelbër". Publikim i INDEP.

26 Arben Vitia, kandidat i LVV-së për kryetar të Prishtinës. Prona Jone, Programi Qeverisës 2025. Përparim Rama, kandidat i LDK-së për kryetar të Prishtinës. Për më shumë shih <https://dpl.us/rx9> Uran Ismaili, kandidat i PDK-së për kryetar të Prishtinës. Për më shumë shih <https://dpl.us/vbu>

Konkluzionet dhe rekomandimet për politika

Kjo përmbledhje e shkurtër politikave i kontribuon fillimit të një diskutimi publik për nevojën për ta inkurajuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen e të rinjve kosovarë në hartimin e politikave publike mjedisore, për t'i edukuar ata dhe për t'i njohur ata si agjentë të ndryshimit.

Në këtë analizë është shqyrtuar shkalla e përfshirjes së të rinjve në hartimin e politikave mjedisore dhe roli i akterëve shoqërorë në lehtësimin e këtij procesi. Çështja kryesore që e kemi trajtuar është se sa është duke u ndërtuar një partneriteti i qëndrueshëm me të rinjtë kosovarë për ta mbrojtur mjedisin. Prandaj, në pjesën e parë ne e kemi vlerësuar gjendjen e përgjithshme duke u bazuar në të dhënat dytësore dhe i kemi hartëzuar institucionet kryesore dhe rolin e tyre. Në pjesën e dytë, ne e kemi parë rolin e akterëve shoqërorë, siç janë organizatat e shoqërisë civile dhe partitë politike në edukimin dhe inkurajimin e të rinjve për ta mbrojtur mjedisin, për të marrë pjesë në hartimin e politikave mjedisore dhe për ta monitoruar zbatimin e politikave të tilla.

ANALIZA EVIDENTON:

- ❖ një pamje shqetësuese në të cilën i riu kosovar nuk njihet si agjent i ndryshimit, pra nuk identifikohet ndonjë qasje institucionale e bashkërenduar për ta synuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen e të rinjve në politikat mjedisore,
- ❖ evidentimin e përpjekje të dobëta institucionale drejt ndërtimit të një partneriteti të qëndrueshëm me të rinjtë kosovarë,
- ❖ mungesën e një departamenti/divizioni institucional përgjegjës për edukimin e vazhdueshëm të të rinjve në drejtim të mbrojtjes së mjedisit dhe avancimit të njohurive të tyre lidhur me mjedisin,
- ❖ mungesën e përpjekjeve dhe aktiviteteve të partive politike për ta lehtësuar përfshirjen e të rinjve në hartimin e politikave për mjedisin apo për t'i edukuar ata për mjedisin.
- ❖ një rol proaktiv të organizatave të shoqërisë civile përmes aktiviteteve të ndryshme në drejtim të vetëdijesimit për mbrojtjen e mjedisit.

PËR T'I TRAJTUAR SFIDAT DHE PROBLEMET E LARTPËRMENDURA, AKTERËT PËRKATËS DUHET T'I TRAJTOJNË SERIOZISHT REKOMANDIMET PËR POLITIKAT NË VIJIM:

- ❖ ka nevojë për një orientim politik më të fuqishëm në trajtimin e sfidave mjedisore dhe prioritizimin e politikave të tilla,
- ❖ ka nevojë për një adresë institucionale që do të ishte përgjegjëse për dimensionin e edukimit të të rinjve, meqë ky mbetet parakusht kryesor për njohjen e të rinjve si agjentë të ndryshimit mjedisor,
- ❖ ka nevojë për përpjekje sistematike dhe të bashkërenduara midis institucioneve (Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Rinisë) për ta inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve në politikat mjedisore duke i shtuar njohuritë e tyre në këtë aspekt.
- ❖ partitë politike duhet ta luajnë një rol më aktiv drejt ngritjes së vetëdijes për mjedisin në mesin e qytetarëve, veçanërisht gjeneratave të reja. Partitë politike i kanë strukturat e tyre në mbarë vendin, kështu që, në aspektin e organizimit dhe menaxhimit, kjo nuk do të ishte detyrë sfiduese për to.
- ❖ Organizatat e shoqërisë civile duhet të vazhdojnë të përdorin qasje proaktive për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet aktiviteteve mjedisore të të rinjve, fushatave të vetëdijesimit dhe përfshirjes së tyre të drejtpërdrejtë në monitorimin e politikave mjedisore.

